

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**, gjyqtari Besim Susuri, me procesmbajtësen Firdes Santuri, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Petrit Randobrava, nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 par.1.3, nenit 9 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, në bazë të nenit 31,73 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë 23 dhjetor viti 2013 marr këtë:

### AKTVENDIM

I pandehuri:

**Petrit Randobrava**, nga i ati Masar, i lindur më 1962 në Prishtinë, me vendbanim në Prizren, rruga "Behari" nr.5, i martuar, baba i dy fëmijëve, din shkrim lexim, ka të kryer fakultetin e arqitekturës, me profesion arqitekt, i gjendjes së mesme pronësore, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

### ËSHTË PËRGJEGJËSE

Sepse, si zyrtar i lartë- Këshilltarë i Kuvendit Komunal në Prizren, duke mos vepruar sipas kërkesës së Agjencionit Kundër Korrupsion, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012 deri më afatin e paraparë Ligjor 31.03.2012.

Me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni neni 5,6 par.1.3, nenit 9 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, për këtë:

### DËNOHET

**Me gjobë në lartësi prej 300 €. (treqind) Euro.**

I pandehuri është i obliguar që gjobën e shqiptuar ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit, në të kundërtën gjoba do të zëvendësohet me dënim burgimi në atë mënyrë që për çdo **20 Euro** te gjobës do të caktohet një ditë burgim. Obligohet se në afatin e njëjtë ti paguaj shpenzimet e procedurës, shumë paushalle prej **5€**. me kërcënim të përmbarimit me detyrim. Obligohet i pandehuri që pas kryerjes së gjobës dhe të shpenzimeve për këtë ta njoftoi Gjykatën Themelore në Prizren - Divizionin e kundërvajtjes.

### Arsyetim

Duke vepruar sipas kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të Agjencisë Kundër Korrupsion në Prishtinë, me nr. 01-1882/12 të datës 24.05.2012, është zhvilluar procedurë kundërvajtëse

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA NR. FOLV - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <b>DPE / DMP</b>	Nr. Prot <b>03-99/14</b>
Dep. <b>DPE / DMP</b>	Sr. Prot <b>03-99/14</b>
Nr. i faq. <b>03</b>	Prot No <b>03-99/14</b>
Broj stranica <b>03</b>	Data <b>10.01.2014</b>
Nr. pages <b>03</b>	Datum <b>10.01.2014</b>
PRISHTINE	

kundër të pandehurit Petrit Randobrava, nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 par.1.3, nenit 9 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050.

Gjendja faktike e përshkruar më për së afërmi si në dispozitiv të aktvendimit është vërtetuar në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të Agjencisë Kundër Korrupsion në Prishtinë, me nr. 01-1882/12 të datës 24.05.2012, nga mbrojtja e të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit Samir Hoxha, zyrtar kontaktues për Kuvendin Komunal në Prizren, dëshmisë së Ibrahim Krasniqi, shef i shërbimit profesional të KK në Prizren dhe dëshmisë së Agron Behrami, zyrtar i Agjencionit Kundër Korrupsion dhe me administrimin e provave tjera nga shkresat e lëndës.

I pandehuri **Petrit Randobrava**, në mbrojtjen e vetë të dhënë në këtë gjykatë përkitazi me kryerjen e kundërvajtjes për të cilën ngarkohet, ka theksuar se: në fillim të mandatit të tij në vitin 2009 ka bërë deklarin e pasurisë duke plotësuar formularin të cilin e kishte pranuar nga zyrtari i KK në Prizren, Z. Ibrahim Krasniqi, mirëpo për vitet vijuesenuk e ka plotësuar të njëjtin formular duke menduar se vetëm në fillim të mandatit një herë ka pas obligim Ligjor ta bëjë, për vitin 2012 këtë nuk e ka bërë, nga shkak se nuk ka qen i informuar.

Mbrojtjen e këfillë e të pandehurit është e orientuar në shmangien e përgjegjësisë së tij kundërvajtëse dhe në kundërshtim të plotë me dëshminë e dëshmitarit Ibrahim Krasniqi, andaj si e tillë nuk mund të qëndroi.

Nga deklarata e dëshmitarit **Samir Hoxha**, Zyrtar Kontaktues në KK Prizren, se për vitin 2012 ka qenë zyrtar Kontaktues me AKK-në, ndërsa tani nuk është, deklaron se Agjencioni Kundër Korrupsion, i ka njoftuar ata që ti njoftojnë të gjithë Kuvendarët përkitazi me afatin ligjor për deklarin e pasurisë-deklarin vjetor, të njëjtën gjë ia ka përcjellë shefit të shërbimit profesional për punë të Kuvendit Z. Ibrahim Krasniqi, i cili ka pas për obligim që ta njoftoi çdo njërin zyrtar për obligimin Ligjor për deklarin e pasurisë, që do të thotë se këtë e ka bërë me kohë dhe në afatin e duhur.

Ndërkaq nga dëshmia e dëshmitarit **Ibrahim Krasniqi**, shef i shërbimit profesional për punë në KK të Prizrenit, vërtetohet se: të pandehurin Petrit Randobrava, si shef i shërbimit profesional për punë të KK në Prizren, me kërkesë të kryesuesit të Kuvendit e ka njoftuar të pandehuri dhe në të njëjtën kohë ia ka dorëzuar formularin për deklarin vjetor të pasurisë, me të cilin ka poseduar shërbimi, i cili ka qenë formular sipas Ligjit paraprak, kur i është kërkuar që ti njoftoi anëtarët e Kuvendit për deklarin e pasurisë, nga kryesuesi i kuvendit, as nga pika kontaktuese- personi zyrtar Samir Hoxha, nuk i është dorëzuar formulari përkatës, ashtu që ka qenë i detyruar që anëtarëve të kuvendit tu dorëzojnë formularin të cilët i ka pas në posedim shërbimi, mirëpo, Petrit Randobrava, nuk e ka kthyer formularin e plotësuar.

Përfaqësuesi i Agjencionit Kundër Korrupsion zyrtari **Agron Behrami**, deklaron se: Agjencioni Kundër Korrupsion, në muajin shkurt ka mbajtur një takim me zyrtarët kontaktues nëpër institucione, të nivelit lokal dhe atij qendror, ku të gjithë zyrtarët janë njoftuar lidhur me procesin e deklarimit të pasurisë si dhe është kërkuar lista e zyrtarëve të lartë publik nëpër institucione. Në fillim të muajit mars Agjencioni Kundër Korrupsion ka shpërndarë njoftimin të gjithë zyrtarëve kontaktues, përmes adresës

03-94/14/03  
scg

elektronike dhe nga ata ka kërkuar ti njoftojnë zyrtarët e lartë publik për procesin e deklarimit dhe ta shpërndajnë njoftimin të përcjell tek zyrtarët, pra ka qenë obligim i zyrtarëve kontaktues me i njoftue zyrtarët e lartë publik për deklarimin e pasurisë në pajtim me Ligjin.

Nga e prezantuar sa sipër me pa mëdyshje vërtetohet se në veprimet e të pandehurit Petrit Randobrava, qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të kundërvajtjes nga neni 5,6 par.1.3, nenit 9 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050.

Gjatë caktimit të dënimit janë vlerësuar rrethanat nga neni 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, pesha e kundërvajtjes së kryer, pasoja e shkaktuar, shkalla e përgjegjësisë si dhe rrethanat materiale të pandehurit.

Në rastin konkret gjyqtari aplikoi nenin 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, duke ia shqiptuar dënimin nën masën minimale për këtë kundërvajtje, pasi që i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar, posaçërisht fakti se i njëjti në gjykatë ka shprehë gatishmëri ta deklaroi pasurinë, qëndrimi i tij tejet korrekt në gjykatë, rrethana të cilat nuk e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse, por që në masë të konsiderueshme ndikojnë në zvogëlimin e përgjegjësisë kundërvajtëse.

Shpenzimet e procedurës janë caktuar në bazë të nenit 109 par.2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Me sa u cek sa sipër, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**

**Nr.467/12-05**


**Datë: 23 dhjetor viti 2013**

**Procesmbajtëse**

**Gjyqtari**

***Firdes Santuri***

***Besim Susuri***



**UDHËZIM JURIDIK:** Pala e pa kënaqur, kundër këtij aktvendimi, ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë-Divizionit të Kundërvajtjes, përmes kësaj gjykate.